

Sipas dispozitave të Rregullores së UNMIK-ut me Nr. 2001/35, mbi Pensionet në Kosovë, të datës 22 Dhjetor 2001,

Me qëllim të ekzekutimit të Nenit 14 të Rregullores së UNMIK-ut me Nr. 2001/35 (“Rregullorja e Pensionit”) në lidhje me parashkrimin e mënyrës së krijimit dhe themelimit të Fondit Suplementar Punëdhënës të Pensioneve (“Fondi I Pensionit”).

Bordi Drejtues I Autoritetit Bankar të Pagesave të Kosovës (BPK), në mbledhjen e tij të mbajtur më 25 korrik 2002 përshtat si vijon:

Rregulla 12 për themelimin e Fondit të Pensionit

Neni 1

Sfera dhe qëllimi I Rregullës

1.1 Sfera e Rregullës

Kjo Rregull i adresohet Punëdhënësve për themelimin e Fondit Suplementar Punëdhënës të Pensionit për sigurimin e benefiteve të pensioneve për nëpunësit e tij dhe përfituesit e tij. Gjithashtu kjo Rregull i adresohet entiteteve ligjore të Fondit të Pensionit të krijuara nga Punëdhënësit si truste për administrimin dhe menagjimentin e pensioneve të punonjësve dhe mjeteve të pensionit. Aty ku aplikohet, kjo Rregull i adresohet edhe antarve të Bordit të Drejtorëve të entiteteve të tilla të Fondit të Pensionit.

1.2 Qëllimi I Rregullës

Kjo Rregull zbaton dispozitat e Nenit 14 të Rregullores së Pensionit dhe parashkruan udhizimet e caktuara dhe kërkesat për formimin, krijimin dhe/ose themelimin e Fondit të Pensionit.

Neni 2

Dispozitat e përgjithshme

2.1 Definimi

Të gjitha termet e shfrytzuara në këtë Rregull janë ashtu siq janë definuar dhe caktuar në Rregulloren e Pensionit dhe/ose siq definojnë më pas në këtë Rregull.

“Benefiti I hershëm I pensionit” nënkupton dispozitën në Urdhëresën e Pensionit që lejon pjesmarrësin I cili pensionohet para moshës normale të pensionimit të filloj me pensionin

e asaj/atij. “Benefiti I hershëm I pensionit” mundë të filloj pas moshës 60 vjeqare ose 35 vite shërbim. Pagesat jetsore të “Benefitit të hershëm të pensionit” në pensionet me benefit të definuar kërkon llogaritje nga eksperti që të zvogloj benefited bazuar në moshën e pensionimit.

“Urdhëresa” që I referohet dokumentit të definuar sipas Nenit 1 të Rregullores së Pensionit, që drejton administrimin dhe menagjmentin e skemës së pensionit dhe termet dhe kushtet e sigurimit për pagesën e kontributeve dhe pranimin e pensioneve.

“Statuti” I referohet dokumentit nëpërmes të cilit trupat më të lartë drejtues të një Pundhënësi zgjedhin ose vendosin që të themelojnë dhe krijojnë Fondin Suplementar të Pensionit në formë të trustit të menagjmentit.

“Përfituesi” është personi ose personat e caktuar nga pjesmarrësi të cilve do të ju bëhet pagesa e benefitit të pensionit të atij/asaj në rast se pjesmarrësi vdes para fillimit të pensionit të asaj/atij, ose gjatë periodës së pagesave të pensionit me benefited e pensioneve të asaj/atij të mbetura.

“Pensioni Invalidor” I referohet atij që është I pranuar që të fillojë benefited e pensionit para moshës 65 vjeqare I cili është kualifikuar me pa aftësi të definuar nga SRSG ose nga ligji ose statuti që I jep asaj/atij të drejtën që të fillojë pensionin, ose si do të definohet në Urdhëresën e Pensionit, në pajtim me ligjet e aplikueshme.

“Pensioni I shtyer” nënkupton benefitin e pensionit që I garantohet pjesmarrësit me përfundimin e punësimit që ndodh para moshës së pensionit mirpo për të cilin fillimi I pagesës së pensionit shtyhet derisa ai/ajo të arrij moshën normale të pensionit ose pensionin e hershëm të pranuar.

“Trupat më të lartë drejtues” të një Pundhënësi që I referohen bordit të drejtorëve të entitetit të korporatës, aksioneve të bashkuara ose asociaicionit, partnerët drejtues ose partnerët në partneritet dhe/ose pronari në gjysëm pronësi.

“Moshë normale e pensionimit” nënkupton moshën 65 vjeqare, dhe “benefiti normal I pensionit” nënkupton benefitin e pensionit të pjesmarrësit që fillon pasi ajo/ai arrij moshën normale të pensionit.

“Sponsor” nënkupton Pundhënësin që themelon dhe krijojnë Fondin Suplementar Pundhënës të Pensionit.

“Regjistri I Fondit të Pensionit” nënkupton librin ose regjistrin e mbajtur nga BPK-ja që përmban listën e të gjitha Fondeve të Licensuara, Sponsorëve të tyre dhe Kosponsorëve dhe kopjet e Urdhëresave të tyre.

“Të drejtat e rezervuara” të pjesmarrësit nënkupton interesin ose benefitin e pjesmarrësit ose përfituesit në mjetete e Fondi të Pensionit që nuk guzojnë të humben ose konfiskohen, mirpo ato të drejta për të pranuar dhe shfrytëzuar benefitin vijë në shprehje

vetem kur pjesmarrësi arrin moshën normale të pensionimit, moshën e pensionimit të hershëm, kualifikimin e invaliditetit ose vdekjen e pjesmarrësit.

Neni 3

Themelimi I Pensionit Suplementar Pundhënës (Fondi I Pensionit)

3.1 Kërkesat e përgjithshme

- a) Statuti i ekzekutuar nga Pundhënësi që sponzoron Fondin e Pensionit themelon Fondin e Pensionit. Statuti, duhet në mes tjerash të specifikoj:
 - 1) Krijimi I një entiteti të Fondit të Pensionit të pavarur dhe jo profitabil në formë të trustit të menagjemntit për administrim dhe menagjment të një skeme të pensionit të pundhënësit sponzorues dhe mjetetë e afërta të pensionit.
 - 2) Numri I bordit të drejtorëve të Enitetit të Fondit të Pensionit, I cili numër nuk është më I vogël se 3 ose më I lartë se 15 që do të veprojnë si fiduciare e mjeteve të pensionit dhe të jetë përgjegjës për administrimin e përgjithsëm dhe menagjmentin e Fondit të Pensionit.
 - 3) Bordi I Drejtorëve duhet të përbëhet prej antarëve të emruar nga Sponzori dhe antarët që prezantojnë pjesmarrësit. Statuti do të specifikoj menyrën me të cilën antarët e Bordit të Drejtorëve janë zgjedhur. Antarët që përfaqsojnë pjesmarrësit duhet të përbëjnë shumicën. Nëse ekziston Sindikata e Puntorëve që përfaqson punonjësit, përfaqësuesit e pjesmarrësve mund të emrohen nga Sindikata e puntoreve. Nëse nuk ka Sindikatë të Puntorëve, mekanizmat tjerë për zgjedhjen ose emrimin e përfaqësuesve të pjesmarrësve duhet të specifikohet në Statut. Nëse antarët duhet të zgjedhen, duhet të shfrytzohej procedurë e thjeshtë e zgjedhjes se dizajnuar që të minimizoj koston.
 - 4) Dokumentimi I emrimit të antarëve për Bordin e parë të Drejtorëve duhet të dorzohet në BPK, e vërtetuar nga Sponzori I Fondit të Pensionit dhe Sindikata e puntorëve, nëse aplikohet. Kualifikimi I antarëve të Bordit të Drejtorëve varet nga aprovimi paraprak nga BPK-ja.
 - 5) Kur Bordi I Drejtorëve të Fondit të Pensionit është zgjedhur ose emruar dhe antarët janë kualifikuar nga BPK-ja, pranon drejtim dhe kontroll të plotë dhe të pavarur të administrimit dhe menagjmentit të Fondit të Pensionit.

- 6) Kushti ose kushtet e zyrës së antarëve të bordit të drejtorëve, procedurat për zgjedhjen dhe emrimin e tyre, kualifikimet dhe bazat për largimin e tyre.
 - 7) Angazhimi i Sponzorit që të bëjë kontribute të pensionit sipas marrveshjes relevante. Në lidhje me Pensionet me Benefit të Definuar, Sponzori duhet të pajtohet që të jep kontribute të mjaftueshme që të mbaj planin e financimit të pensionit në pajtim me Rregulloren e Pensionit 14.11 që të financoj plotsisht. Benefitet e shërbimit të ruajtur dhe që rritet brenda periodës jo më të shkurtër se njëzet vite.
- b) Bordi I Drejtorëve të Fondit të Pensionit dhe Sponzori përshtatin Urdhëresën e Pensionit dhe ndërmarrin një kampanjë informative në lidhje me Urdhëresat dhe rregullimet pensionale tek punonjësit që janë të pranueshëm për pjesmarrje në skemën e pensionit.
 - c) Bordi I Drejtorëve emron Kujdestarin dhe Menagjerin e Pronave, nëse aplikohet në pajtim me kërkesat e Rregullës 8 dhe 10, të këtyre Rregullave.
 - d) Bordi I Drejtorëve së bashku me Sponzorin aplikojnë për licensën e Fondit të Pensionit dhe regjistrim në BPK në pajtim me kërkesat e Rregullës 1 të këtyre Rregullave.
 - e) Lëshimi I licensës së Fondit të Pensionit dhe qertifikata e regjistrimit nga BPK-ja përfundon procesin e krijimit të Fondit të Pensionit si entitet ligjor.

3.2 Kërkesat specifike

- a) Urdhëresat e Pensionit. Dokumenti me shkrim (së bashku me ndryshimet e tij, nëse ka ndonjë) I nënshkruar nga antarët e bordit të drejtorëve të Fondit të Pensionit dhe oficeri I autorizuar që përfaqson trupin më të lartë të Sponzorit, që përmban marrveshjet si vijojnë:
 1. Forma e Fondit të Pensionit (Benefiti I Definuar ose Kontributi I Definuar).
 2. Emri, lokacioni, dhe kërkesat bankare të Fondit të Pensionit dhe Sponzori.
 3. Procedurat për zgjedhjen e drejtorëve të Fondit të Pensionit dhe procedurat dhe kërkesat për zhvillimin e mbledhjes së tij të bordit, e cila mbledhje duhet të mbahet jo më rrall se 6 muaj.
 4. Termet për regjistrimin e nëpunësve individual si pjesmarrës të Fondit të Pensionit.

5. Kategorit profesionale të nëpunësve që marin pjesë në Fondin e Pensionit, nëse nuk marrin pjesë të gjithë nëpunësit.
6. Procedura për dhënjen e kontributeve dhe obligimet e pundhënësit dhe nëpunësve (nëse aplikohet) që të kontribuojnë.
7. Procedura për determinimin e metodologjisë statistikore që do të shfrytzohej në bërjen e pagesave të pensioneve me Benefit të Definuar.
8. Për Fondin e Pensionit me Benefit të Definuar, plani për determinimin e të Drejtave të Rezervuara të pjesmarrësve, duke treguar vitet e shërbimit të kërkuara për një të drejtë të shtuar që mos të tejkaloj 5 vite; metodologjia e shfrytëzuar për llogaritjet që determinojnë shumën e kërkuar të kontributit të pundhënësit për të plotsuar kërkesat e financimit të plotë të Rregullores së Pensionit 14.11; procedura, koha dhe mënyra, për pjesmarrësit që të pranojnë ekstraktet e raportuara mbi zhvillimin e menagjmentit të mjeteve të Fondit të Pensionit.
9. Për Fondet e Pensionit me Kontribut të Definuar, deklarata është si e të Drejtave të Rezervuara plotsisht të pjesmarrësve të të gjitha mjeteve të pensionit të shpërndara në Llogaritë Individuale; procedurat për mbajtjen e shënimeve në lidhje me kontributet dhe zhvillimin e investimeve (fitimi ose humbja) në Llogaritë Individuale; njohtimi për pjesmarrësit për shumën që kanë në Llogaritë Individuale, jo më rrall se në vit.
10. Për Fondin e Pensionit me Benefit të Definuar që ofrojnë benefite të pensionit të hershëm, përshkrimi I reduktimit të ekspertit që ti bëhet benefiteve në mënyrë që të akomodojnë pagesën e pensionit të hershëm.
11. Obligimet e Fondit të Pensionit.
12. Deklarata e principeve të investimit për mjetet e pensioneve (duke përfshirë shpërndarjen e mjeteve, përzjerjen, shpërndarjen dhe qështje tjera) dhe procedura për zgjedhjen e Menagjerit të Pronave në përshtatshmëri të plotë me nenin (b) të këtij nënseksioni.
13. Procedura për zgjedhjen e Kujdestarit dhe ruajtjen e mjeteve të pensionit.
14. Termet, procedurat dhe format e pagesës së Pensionit për pjesmarrësit, duke përfshirë, nëse aplikohen benefitet e pensionit të hershëm,

benefitet e pensionit invalidor, dhe benefitet ndaj partnerit që ende është gjallë; Termet dhe shumat e benefiteve të tilla dhe të drejtat e përfituesve.

15. Termet dhe procedurat për transferin e pjesmarrësit ose të drejtës së asaj/atij për benefitet e shtyera të pensionit në rast të përfundimit të punsimit, të drejtat e pjesmarrësit për të transferuar në rast të likudimit ose bankrotimit të Sponzorit.
 16. Procedurat dhe formalitetet e kërkuara në amandamentet e Urdhëresës.
 17. Procedurat e kërkuara në shuarjen e Fondit të Pensionit.
 18. Dhe dispozita tjera të tilla që BPK-ja mund të kërkojë koh pas kohe.
- b) Deklarata e Principeve të Investimit. Kjo pjesë e Urdhëresës duhet të përmbajë së paku dispozitat si vijojnë:
- 1) Karakteristikat kualitative të investimeve që të sigurojnë siguri dhe profitabilitet në investime.
 - 2) Objektivat kuantitative të të ardhurave të investimeve dhe mënyra me të cilën objektiva do të arrihet vit pas viti.
 - 3) Limiti maksimal proporcional që mund të vendoset në një lloj të investimit, në pajtim me kërkesat e Rregullores së Pensionit.
 - 4) Limiti maksimal proporcional që mund të investohet në një emitues ose në një entitet.
 - 5) Format, llojet dhe klasat e investimeve ku mjetet nuk mund të vendosen.
 - 6) Kërkesat minimale të likuiditetit ose dispozitat e përgjithshme të investimeve totale.
 - 7) Mënyra me të cilën zhvillimi i investimeve është raportuar nga bordi i drejtorëve për pjesmarrësit dhe BPK-n.
 - 8) Shfrytëzimi i këshillave të ekspertit nga menagjeri i pronave, planifikuesit e investimeve, kshilltarët financiar dhe profesionalistët tjerë në investimet e mjeteve të pensioneve.

- 9) Një sistem intern ose mekanizëm ku pjesmarrësit mund ti parashtrojnë propozimet dhe komentet në lidhje me investimet dhe mënyrën me të cilën bordi I drejtorëve I adreson ato.
- 10) Koha, frekuenca dhe mënyra në të cilën Bordi I Drejtorëve shqyrton deklaratën e principeve të investimeve, procedura nëpërmes të cilës ndryshimet janë bërë dhe procedurat me të cilat pjesmarrësi dhe BPK-ja janë njohtuar për këto ndryshime.

Neni 6

Principet dhe udhizimet për themelimin e Fondit të Pensionit

Për themelimin e Fondit të Pensionit dhe formulimin e Urdhëresës dhe në implementimin e programit të pensionit, principet si vijojnë dhe udhizimet do të zbatohen:

- a) Segregimi I mjeteve të pensionit. Fondi I Pensionit është entitet ligjor I veçantë nga Sponzori. Mjetet e pensioneve duhet vazhdimisht të jenë të ndara nga mjetet e Sponzorit në të gjitha qështjet në lidhje me kontrollin, kujdestarin, investimin dhe menagjmentin.
- b) Implementimi I sistemit financues. Mjetetë e Pensioneve duhet të përbëhen nga kontributet e Fondit të Pensionit të bëra nga ose në emër të nëpunësve dhe fitimi I investimit që rrjedh nga këtu. Në rast të pensioneve më Kontribut të Definuar, kontributet plus fitimet e investimit, minus shpenzimet, duhet të përbëjnë financimin e pensionit. Në pensionet me benefit të definuar, Fondi I Pensionit duhet të zhvilloj planin e financimit. Mjetet e pensioneve duhet të lejohen që të akumulohen në atë mënyrë që do të mundësojn Fondin e Pensionit që në mënyrë adekuate te paguaj premtimet e pensioneve. Sponzori është I lidhur për detyrën që të sigurojqë premtimet e pensioneve ose detyrimet janë financuar ashtu siq është kërkuar nga Rregullorja e Pensionit 14.11. Libri I regjistrimit osedetyrimet e mbajtura nga Sponzori për financimin e Fondit të Pensionit nuk është e lejuar.
- c) Mbështetja dhe transparenca. Fondet e Pensionit duhet të mbështesin vetëm objektivat e Fondit të Pensionit që të sigurojnë pensionet dhe mjetet që janë investuar vetëm për të mbështetur objektivat e pensionit. Administrimi dhe menagjmenti I Fondit të Pensionit duhet të zhvillohet me transparencën më të lartë duke I kërkuar bordit të drejtorëve që të sigurojnë informatat e caktuara për pjesmarrësit në lidhje me mjetet dhe të drejtat e tyre përkatse.
- d) Mbikqyrja. Investimi, kujdestaria dhe shfrytzimi I mjeteve të pensionit janë të nënshtruara mbikqyrjes që të sigurojnë që mjetet e pensioneve

janë shfrytzuar vetëm për pagesën e titullimeve të pensionit. BPK-ja duhet të mbaj Regjistrin e Fondeve të Pensioneve që do të jetë I hapur për shikim publik gjatë orarit të pershtatshëm të punës.

- e) Bllokimi I interesave të pjesmarrësit. Interesi I pjesmarrësve në Fondin e Pensionit është e drejtë pronsore e asaj/atij, mirpo kjo e drejtë pronësore është në dispozicion për ate/atë vetëm për pagesat e pensionit kur ajo/ai arrin moshën e pensionimit, pensionimin e hershëm ose pensionin invalidor siq është autorizuar nga Urdhëresa, ose për përfituesin(et) e asaj/atij në rast vdekjes para fillimit të pensionit.

Neni 5
Hyrja në fuqi

Kjo rregull do të hyj në fuqi më 25 korrik 2002.

Drejtori i Përgjithshëm